



Data: 11.08.2017 Ref.: 707/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.557/17, datë 19.07.2017 e BPrAL Kolegji “Arbëri” në Gjilan për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr.577/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.577/17, datë 06.07.2017
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Arbëri” me 19.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr. 577/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim BPrAL Kolegji Arbëri i është pezulluar akreditimi këtyre programeve: Juridik, LLM, 240 ECTS; Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS; Menaxhment, BA, 180 ECTS, dhe Menaxhment, MA, 120 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit te dorëzuar nga BPrAL Kolegji Arbëri, është konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka staf te mjaftueshëm me dokumentacion te rregullt siç kërkohet me Udhëzimit Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016) mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (UA për Akreditim). Sipas nenit 11, pika 3.2 e UA për Akreditim për secilin program të studimit duhet të kenë të paktën tri staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc. apo ekuivalent me te. Kolegji Arbëri edhe me kërkesën për rishqyrtim nuk ka arritur që te siguroj staf te mjaftuar akademik për programet e studimit Menaxhment, MA (120 ECTS) për të cilin ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim te vendimit, dhe mbi këtë bazë KSHC vendosi si në dispozitave të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Arbëri";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

